

MOBILIZUES

PRAK është OJQ për të drejtat e pacientëve, e cila kontribuon në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të pacientëve.

Me fitimin e grantit **GrassRoots Action Support – GRAS**, i mbështetur nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe ne si realizues te projektit **“Rrugëtimi i grupeve të cenushme nëpër shërbime shëndetësore”** kërkojmë djem dhe vajza të reja për vendin e punës **Mobilizues**.

Organizata jonë do të ofrojë:

- Pajisje të nevojshme për takime,
- Pagë konkurruese,
- Mundësi zhvillimi profesionalisht në një OJQ vazhdimisht në rritje.

Pozita: Mobilizues

Ne jemi duke kërkuar Mobilizues në teren-qytetin e Suharekës. Mobilizuesi do të jetë përgjegjës në kontakte të rregullta me komunitete në Komunën e Suharekës.

Mobilizuesi duhet të jetë komunikativ dhe analitik, i gatshëm të mësoj gjëra të reja dhe veçanërisht pasionant.

Përgjegjësitë kryesore:

- T'i raportoj direkt Menaxherit të projektit,
- Identifikimin, vlerësimin dhe zgjidhjen e kërkesa të qytetarëve,
- Të intervistoj sa më shumë dhe sa më kualitativë qytetarët,
- Kupton dhe i respekton procedurat e komunikimit, udhëzimet dhe politikat e OJQ-së,
- Vlerëson mundësinë e anketës dhe sigurohet që anketa është e kompletuar,
- Përshtatet në punë ekipore dhe
- E sjellë një buzëqeshje në vendin e punës

Kualifikimet e kërkuara:

- Eksperiencë në fushën e shërbimit, në fushën relevante
- Aftësia e menaxhimit të shumë detyrave në të njëjtën kohë
- Komunikim të mirë dhe aftësi të mira në vendimmarrje

Të gjithë kandidatët e kualifikuar do të konsiderohen për punësim në organizatën tonë pa dallim race, ngjyre, besimi apo gjinie.

Si të aplikoj?

Kandidatët që e shohin veten si të përshtatshëm për këtë pozitë dhe që mendojnë se do të kontribuonin dhe besonin në kulturën e organizatës janë të inkurajuar të aplikojnë me CV të përditësuar në email adresën info@prak-kosova.org, me subject “Mobilizues”, apo në zyrat e organizatës, adresa rr. 11 Marsi Lam3B nr.2 në Ortakoll, Prizren.

Data e fundit për aplikim është **28.06.2020**.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen.

I mirëpresim aplikacionet e juaja!

“Ky botim është prodhuar me përkrahjen e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e OJQ PRAK dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i Bashkimit Evropian ose IKS-së, Lens, apo FES”

Përkrahur nga:

Implementuar nga: